

Publikimi teknik – PT 16

Kriteret dhe procedura për aprovimin e shërbimeve në tokë

Mjetet e pranueshme të përputhshmërisë me
Rregulloren e ndryshuar nr. 04/2011 të AAC-
së

Parathënie

Në pajtim me Nenin 10 të Rregullores nr. 4/2011 për Qasjen në tregun e shërbimeve në tokë, të ndryshuar me Rregulloren (AAC) nr. 05/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 4/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë, Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës (AAC) i bën publike kriteret e aprovimit të çdo përdoruesi të aeroportit që dëshiron të vetëshërbehet dhe për çdo furnizues të shërbimeve në tokë në aeroporte, pa kufizime. Prandaj, qëllimi i këtij Publikimi Teknik është që të përshkruaj kriteret për dhënien e aprovimit për shërbime në tokë si dhe procedurat për dhënien e aprovimit të tillë nga AAC-ja.

Kriteret janë të natyrës së sigurisë dhe asaj financiare, prandaj ky Publikim Teknik është përgatitur nga Departamenti për Mbikëqyrjen e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, Aerodromeve dhe Rregullim Ekonomik, në veçanti nga Divizioni për Aerodromet dhe Divizioni për Rregullim Ekonomik të Aviacionit në kuadër të AAC-së. Aplikimi për aprovim si furnizues i shërbimeve në tokë i nënshtrohet rishikimit dhe vlerësimit të kryer nga AAC-ja.

Ky publikim vlen për organet menaxhuese të aeroportit të interesuara në ofrimin e shërbimeve si palë e tretë, përdoruesit e aeroportit që dëshirojnë të vetëshërbehen dhe furnizuesit e shërbimeve në tokë në aeroportet e vendosura në territorin e Republikës së Kosovës, e që i nënshtrohen Rregullores së ndryshuar të AAC-së nr. 04/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë.

Ky doracak është i qasshëm për të gjitha palët e interesuara në ueb faqen zyrtare të AAC-së: www.caa-ks.org.

Eset Berisha
Drejtori i Përgjithshëm

Autoriteti i Aviacionit Civil

Lista e faqeve efektive

Kapitulli	Faqe	Nr. i rishikimit	Data efektive
Parathënie	2 nga 16	Ver. 2	13 gusht 2019
Lista e faqeve efektive	3 nga 16		
Përmbajtja	5 nga 16		
Termet dhe përkufizimet	6 nga 16		
	7 nga 16		
Kapitulli 1 - Fushëveprimi, qëllimi dhe kërkesat rregullatore	8 nga 16		
	9 nga 16		
Kapitulli 2 - Kriteret për aprovimin e shërbimeve në tokë	9 nga 16		
	10 nga 16		
Kapitulli 3 - Procedura për aprovimin e shërbimeve në tokë	11 nga 16		
	12 nga 16		
	13 nga 16		
Kapitulli 4 - Mbikëqyrja e shërbimeve në tokë të aprovuara	14 nga 16		
	15 nga 16		

	Emri dhe pozita	Data	Nënshkrimi
Përgatitur nga:	Besnike Ukmata , u.d. Drejtoreshë e Divizionit për Rregullim Ekonomik të Aviacionit Alban Ramabaja , Inspektor i Aerodromeve	09.08.2019	
Autorizuar nga:	Arianit Islami , u.d. Drejtor i Departamentit për Mbikëqyrjen e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, Aerodromeve dhe Rregullimit Ekonomik	09.08.2019	
Kontrolli i Cilësisë nga:	Lendita Kika-Berisha u.d. Drejtoreshë e Njësisë për Menaxhimin e Cilësisë dhe Sigurisë	13.08.2019	
Aprovuar nga:	Eset Berisha Drejtor i Përgjithshëm	13.08.2019	

Përmbajtja

Parathënie	2
Lista e faqeve efektive	3
Përmbajtja	4
Termet dhe përkufizimet	5
Kapitulli 1 - Fushëveprimi, Qëllimi dhe Kërkesat Rregullatore	7
1.2. Qëllimi	7
1.3. Kërkesat rregullatore	7
Kapitulli 2 - Kriteret për aprovimin e shërbimeve në tokë	9
Kapitulli 3 - Procedura për aprovimin e shërbimeve në tokë	11
3.1 Takimi prezantues	11
3.3 Verifikimi i dokumenteve të dorëzuara	11
3.4 Dhënia e aprovimit	11
3.5 Vlefshmëria e aprovimit	11
3.6 Vazhdimi i aprovimit	11
3.7 Ndryshimi i aprovimit	12
Kapitulli 4 - Mbikëqyrja e ofruesve të aprovuar të shërbimeve në tokë	13

Termtat dhe përkufizimet

Aeroport	nënkupton çfarëdo sipërfaqe tokësore e përshtatur në veçanti për aterrim, ngritje dhe manovrim të avionit, duke përfshirë objektet ndihmëse që këto operacione mund të përfshijnë për nevojat e trafikut të avionëve dhe shërbimeve duke i përfshirë objektet e nevojshme për të ndihmuar shërbimet komerciale ajrore;
Organ menaxhues i aeroportit	nënkupton organin i cili, në ndërlidhshmëri me aktivitetet tjera ose jo, sipas rastit, ka si objektiv të vet sipas ligjit apo rregulloreve të Republikës së Kosovës administrimin dhe menaxhimin e infrastrukturës së aeroportit, koordinimin dhe kontrollin e aktiviteteve të operatorëve të ndryshëm prezentë në aeroport ose sistemin e aeroporteve në fjalë;
Përdoruesi i aeroportit	nënkupton çdo person fizik ose juridik me përgjegjësi për bartjen e udhëtarëve, postës dhe/ose mallrave përmes ajrit deri në, ose prej aeroportit në fjalë;
Shërbimi në tokë	nënkupton shërbimet e ofruara për përdoruesit e aeroporteve, në aeroporte siç është përshkruar në Shtojcën e Rregullores nr. 04/2011;
Vetëshërbimi	<p>nënkupton një situatë në të cilën një përdorues i aeroportit në mënyrë direkte ofron për vetveten një ose më shumë kategori të shërbimeve në tokë dhe nuk lidh asnjë kontratë të çfarëdo përshkrimi me palën e tretë për ofrimin e shërbimeve të tilla; për qëllim të këtij përkufizimi, përdoruesit e aeroportit nuk do të konsiderohen si palë e tretë mes vete kur:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ njëri mban shumicën e aksioneve në tjetrin; ose▪ një organ i vetëm mban shumicën e aksioneve në secilin;
Furnizuesi i shërbimeve	nënkupton çdo person fizik ose juridik që furnizon

në tokë	palët e treta me një ose më shumë kategori të shërbimeve në tokë;
AAC	nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës;
HPEA ose Marrëveshja HPEA	nënkupton Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit, ose Marrëveshja që përcakton HPEA-në e cila përfshin Marrëveshjen Kryesore, Shtojcat dhe Protokollet e saja.
Marrëveshja PPP	nënkupton Marrëveshjen e Partneritetit Publiko-Privat për Operimin dhe Zgjerimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës ndërmjet Republikës së Kosovës duke vepruar përmes Komitetit Drejtues Ndërministror për Partneritet Publiko-Privat dhe Limak Kosovo International Airport SH.A., të datës 12 gusht 2010.

Kapitulli 1 – Fushëveprimi, Qëllimi dhe Kërkesat Rregullatore

1.1. Fushëveprimi

Ky Publikim Teknik vlen për organin menaxhues të aeroportit, ku ofrohen shërbime si palë e tretë, përdoruesit e aeroportit që dëshirojnë të vetëshërbehen dhe furnizuesit e shërbimeve në tokë në aeroportet e vendosura në territorin e Republikës së Kosovës, e që i nënshtrohen Rregullores së ndryshuar nr. 04/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë.

1.2. Qëllimi

Ky Publikim Teknik publikohet për qëllime të përcaktimit të procedurave dhe kriterëve për dhënien e aprovimit nga AAC-ja për ofrimin e shërbimeve në tokë, sipas Nenit 11 të Rregullores së ndryshuar nr. 04/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë.

1.3. Kërkesat rregullatore

1.3.1 Direktiva e Këshillit 96/67 e datës 15 tetor 1996 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë në aeroportet e Komunitetit i kërkon Shteteve Anëtare që të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të hapur tregun e shërbimeve në tokë në aeroportet e mëdha. Në atë mënyrë, mund të sigurohet se kompanitë ajrore mund të zgjedhin furnizuesin e tyre të shërbimeve në tokë sipas nevojave të tyre.

1.3.2 Neni 69 i Ligjit nr. 03/L-051 mbi Aviacionin Civil thekson se shërbimi në tokë në aeroporte rregullohet sipas Direktivës së Këshillit 96/67/KE të datës 15 tetor 1996 mbi qasjen në tregun e shërbimeve në tokë në Aeroportet e Komunitetit, dhe të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Direktive. AAC-ja mund të bëjë përjashtime në përputhje me Direktivën e Këshillit 96/67/KE.

Direktiva e Këshillit 96/67/KE është zbatuar në Republikën e Kosovës përmes Nenit 69 të Ligjit mbi Aviacionin Civil dhe Rregullores së ndryshuar nr. 4/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë.

1.3.3 Neni 10 i Rregullores nr. 04/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë, e ndryshuar, përkufizon se AAC-ja duhet të përcaktojë kriteret për dhënien e aprovimit për ofrimin e shërbimeve në tokë për kategoritë e shërbimeve në tokë ku numri i furnizuesve nuk është i kufizuar si dhe vetëshërbimet në përputhje me Nenin 6 të së

njëjtës Rregullore, sipas nevojës, për aeroportet që bien nën fushëveprimin e kësaj Rregulloreje.

1.3.4 Neni 10 i Rregullores nr. 04/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë, e ndryshuar, përkufizon që kategoritë e shërbimeve në tokë ku numri i furnizuesve nuk është i kufizuar si dhe vetëshërbimet në përputhje me Nenin 6 të kësaj Rregullore, secili furnizues i shërbimeve në tokë dhe secili vetëshërbyes duhet të aplikojë me shkrim në AAC për aprovim, para angazhimit në aktivitetet e shërbimit në tokë në një aeroport. Dhënia e aprovimit bëhet me kërkesë të furnizuesit të shërbimeve në tokë ose përdoruesit të aeroportit që dëshiron vetëshërbime bazuar në kriteret e përcaktuara. AAC-ja duhet t'i specifikojë dhe publikojë ato kriteret.

1.3.5 Në rastet e kufizimit/përrjashtimit, ofruesi duhet të veprojë, përveç marrjes së aprovimit, në përputhje me dispozitat që përcaktojnë kushtet e procedurës së tenderimit. Përzgjedhja e furnizuesve tregohet në Nenin 11 të Rregullores së ndryshuar nr. 04/2011.

Kapitulli 2 - Kriteret për aprovimin e shërbimeve në tokë

Për të marrë aprovimin, aplikuesi duhet që së paku të plotësojë kriteret si në vijim:

- a) Të dëshmojë kompetencën organizative dhe kapacitetin për kryerjen e punës në mënyrë të sigurt dhe me kohë në fushëveprimin e aktiviteteve të kërkuara të shërbimeve në tokë në çdo aeroport të kërkuar - të siguruara me anë të vlerësimit nga AAC-ja në bazë të kërkesave të zbatueshme kombëtare dhe ndërkombëtare dhe standardeve IATA - programit ISAGO.
- b) Të dëshmojë kompetencën teknike duke paraqitur doracakun e duhur të operacioneve (në kopje të shtypur dhe elektronike). Doracakun e operacioneve duhet të përmbajë në minimum: strukturën organizative, personelin drejtues, përshkrimin e përgjegjësive dhe detyrave, listën e pajisjeve në përdorim, kërkesat kualifikuese për personelin, kërkesat e trajnimit dhe planin e trajnimit, procedurat e menaxhimit të sigurisë dhe cilësisë, procedurat standarde të trajtimit, procedurat e trajtimit të veçantë në lidhje me operatorët-konsumatorët e caktuar, procedurat për situatat emergjente në aerodrome dhe masat e sigurisë.
- c) Të jetë person fizik ose juridik i regjistruar në Republikën e Kosovës, ose person fizik ose juridik i regjistruar për ofrimin e shërbimeve të në tokë me adresën e biznesit në territorin e shteteve të HPEA-së, me degë rajonale të regjistruar në Republikën e Kosovës ose në shtetet e tjera, me kusht që reciprociteti të sigurohet në përputhje me Nenin 18 të Rregullores së ndryshuar nr. 04/2011. Duhet të dorëzohet certifikata e regjistrimit të biznesit e lëshuar nga autoritetet Kosovare.
- d) Të dëshmojë aftësinë financiare - që dëshmohet përmes dorëzimit të dokumenteve të mëposhtme:
 - i. Furnizuesit e shërbimeve në tokë
 - Llogaritë vjetore financiare të audituara për dy vitet e fundit financiare (nëse është e aplikueshme)
 - Deklaratën e auditorit mbi përmbushjen e kërkesës sipas Nenit 4 të Rregullores së ndryshuar nr. 4/2011 të AAC-së (nëse është e aplikueshme);
 - Raportet financiare të tremujorit të fundit mbi rezultatet e biznesit (nëse është e aplikueshme)
 - Planin vjetor të biznesit për tri vitet e ardhshme;

- Raportin e investimeve dhe planin e investimeve për vitin aktual dhe tri vitet e ardhshme;
 - Informatat mbi besueshmërinë dhe aftësinë paguese (Dëshmia që tregon se aplikuesi nuk është bllokuar për gjashtë muajt e fundit dhe/ose nuk është duke iu nënshtruar procedurës së falimentimit);
 - Dëshmia që tregon se aplikuesi i ka paguar të gjitha tatimet.
- ii. Përdoruesit e aeroportit që dëshirojnë të vetëshërbehen:
- Licenca e vlefshme operuese, nëse kërkohet.
- e) Të ofrojë policat adekuate të sigurimit nga rreziku, të vlefshme për një periudhë prej së paku një viti, varësisht nga vendndodhja e ofrimit të shërbimeve në tokë, për të mbuluar përgjegjësinë e furnizuesit për dëmet që mund t'ia shkaktojë një pale të tretë, gjatë kryerjes së shërbimit. Për shërbimet e renditura në shtojcën e Rregullores së ndryshuar nr. 4/2011, e cila dispozitë nënkupton edhe pjesën ajrore dhe pjesën tokësore, vlen kufiri i mbulimit të sigurimit për zonën ajrore. Kërkesa minimale e sigurimit do të jetë:
- i. 2.5 milionë euro për shërbimet në tokë të ofruara në zonën tokësore
 - ii. 50 milionë euro për shërbimet në tokë të ofruara në zonën ajrore
 - iii. 250 milionë euro për shërbimet e lëndëve djegëse dhe vajrave.

Përdoruesit e aeroportit që dëshirojnë të vetë-shërbehen janë të obliguar të paraqesin policën e tyre të sigurimit të korporatës.

Nëse aplikuesi nuk ka qasje në treg në një aeroport para se të aplikojë për aprovim, atëherë ai nuk duhet të sigurojë policën e sigurimit të përmendur më lart, përkatësisht. Në një rast të tillë, do të lëshohet një para-aprovim, me kusht që të plotësohen kushtet e tjera të nevojshme, e cila duhet të mjaftojë për të kërkuar qasjen në treg në një aeroport. Pas fitimit të qasjes në treg, atëherë atyre do t'u kërkohet të paraqesin policat e duhura të sigurimit të përcaktuara më lart para se të marrin miratimin përfundimtar.

- f) Kërkesat tjera për ofruesit e shërbimeve të lëndëve djegëse dhe vajrave:
- i. Licenca për biznes në sektorin e naftës – Licenca për depozita e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ose nga një institucion tjetër i autorizuar shtetëror;
 - ii. Licenca për biznes në sektorin e naftës – Licenca për importin e kerozinës, e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ose nga një institucion tjetër i autorizuar shtetëror;

- iii. Licenca për transportin rrugor ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme, e lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit ose nga një institucion tjetër i autorizuar shtetëror.
- g) Kur aplikuesi ka përvojë të mëparshme të operimit si furnizues i shërbimeve në tokë, ose si vetëshërbyes në një shtet të HPEA-së, ai duhet të specifikojë:
- i. Shtetin/shtetet dhe aeroportin/aeroportet e përfshira duke cekur nëse aplikuesi posedon apo ka poseduar aprovimin apo autorizimin nga autoritetet kompetente kombëtare të shtetit/shteteve të tilla.
 - ii. Llojin e aktiviteteve të shërbimeve në tokë dhe kohëzgjatjen e ofrimit të aktiviteteve të tilla.
 - iii. Të dorëzojë kopjen e aprovimit ose dëshmi të tjera të përvojës.
- h) Dëshmia e reputacionit të mirë, duke paraqitur referenca të punës së mirë, mundësisht nga konsumatorët/klientët.

Kapitulli 3 – Procedura për lëshimin e aprovimit të shërbimeve në tokë

3.1 Takimi prezantues

Aplikuesi do të kërkojë takim zyrtar me AAC-në në lidhje me synimet e tij para çdo aktiviteti tjetër.¹ Gjatë këtij takimi, aplikuesi duhet t'i paraqesë AAC-së planet e tij në lidhje me aerodromin. AAC-ja i ofron aplikuesit informata të përgjithshme në lidhje me kërkesat e zbatueshme për aerodromin, kopjet e kërkesave të zbatueshme, formularët e aplikimit, si dhe përshkruan procedurat e procesit të certifikimit.

3.2 Procesi i aplikimit

- Dorëzimi i shprehjes së interesit,
- Vlerësimi i shprehjes së interesit,
- Dorëzimi i aplikacionit formal me dokumentet dhe dëshminë e pagesë së tarifës prej 50%,
- Rishikimi/vlerësimi i aplikacionit dhe dokumenteve (nëse nuk është lejuar qasja në treg, atëherë mund të lirohen nga polica(-t) e sigurimit),
- Auditimi në terren për përputhshmërinë ,
- Rekomandimi për dhënien e certifikatës/aprovimit dhe pagesa e tarifës tjetër prej 50%,
- Dhënia e aprovimit.

3.3 Kërkesa për aprovim

Aplikuesi dorëzon formularin e plotësuar të kërkesës së bashku me informatat/dokumentet e renditura në Kapitullin 2. Të gjitha llojet e kërkesave (fillestare, për vazhdim ose për ndryshim të aprovimit) duhet të bëhen në AAC së paku 6 javë para fillimit të operimeve pasiqë është e rëndësishme që AAC-ja të ketë kohë të mjaftueshme për të trajtuar aplikacionet. Dëshmia e tarifës së zbatueshme duhet të bashkangjitet në dosjen e aplikacionit.

Formulari i aplikimit me numër reference nr. AACK/AGA/FRM/11 (Aplikacioni për dhënien e aprovimit si furnizues i shërbimeve në tokë ose si vetëshërbyes) mund të gjendet në www.caa-ks.org.

¹ Aplikuesit inkurajohen të kontaktojnë autoritetin e aeroportit për të koordinuar procedurën e aplikimit

3.4 Verifikimi i dokumenteve të dorëzuara

AAC-ja verifikon dokumentet e kërkesës për saktësinë dhe mjaftueshmërinë. Në rast të mosaktësisë ose mosmjaftueshmërisë së dokumenteve, aplikuesit i kërkohet të plotësoj dokumentacionin, ose të kryej korrigjimet e nevojshme. Aplikuesi duhet t'i përgjigjet kërkesave shpesh nga AAC-ja brenda afatit të caktuar, të përcaktuara nga AAC-ja, në të kundërtën do të refuzohet kërkesa për aprovim.

3.5 Auditimi i përputhshmërisë

AAC-ja duhet të zhvilloj një auditim në vendngjarje për të verifikuar kompetencën organizative dhe aftësinë për operacione të sigurta të shërbimeve në tokë, në përputhje me Standardet IATA - Programin ISAGO (Standardet e grupit të cilësisë së karburantit IATA).

3.6 Dhënia e aprovimit

Pas dorëzimit dhe verifikimit të të gjitha dokumenteve të nevojshme, AAC-ja do t'i jap aprovimin aplikuesit. Formulari i aprovimit do të përmbajë të dhëna të përgjithshme për vetëshërbyesit/furnizuesit e aprovuar të shërbimeve në tokë, si dhe aeroportet për të cilat vlen aprovimi, kategoritë e aprovuara të shërbimeve në tokë dhe data e skadimit të aprovimit.

3.7 Vlefshmëria e aprovimit

Aprovimi jepet në afat vlefshmërie deri në 7 vjet. Vlefshmëria e aprovimit për organin menaxhues të aeroportit si furnizues i shërbimeve në tokë mund të lëshohet në përputhje me marrëveshjen PPP, për tërë kohën gjatë së cilës kjo marrëveshje është në fuqi.

3.8 Vazhdimi i aprovimit

Aprovimi mund të vazhdohet pas përfundimit të kënaqshëm të auditimit ose vlerësimit nga ana e AAC-së. Aplikuesi duhet të dorëzojë formularin e aprovimit me qëllim të vazhdimit të tij. Pas pranimit të aplikacionit, AAC-ja duhet të kryej një auditim apo vlerësim. Përveç kësaj, AAC-ja do të shqyrtojë të gjitha dokumentet relevante të përcaktuara në Kapitullin 2 për saktësinë dhe mjaftueshmërinë. AAC-ja duhet të nxjerr një raport të auditimit duke deklaruar të gjitha mospërputhshmëritë e gjetura, ndërsa krahas kësaj, aplikuesi duhet të zhvillojë një plan përkatës të veprimit korrigjues dhe ta zbatojë atë brenda periudhës së paraparë kohore në mënyrë që AAC-

ja t'i përmbyll gjetjet e saj. Në rast të mosveprimit si më lartë, mund të krijohet baza për masa detyruese nga AAC-ja.

Pas realizimit të suksesshëm të procedurës së përcaktuar në këtë paragraf, AAC-ja do t'i japë aprovimin e ri aplikuesit me datë të re të vlefshmërisë.

3.9 Ndryshimi i aprovimit

Aprovimi mund të ndryshohet në çdo kohë me kërkesën e poseduesit të aprovimit në mënyrë që të shtohet një aeroport i ri në tabelën e aprovimit, ose të rritet/zvogëlohet fushëveprimi i shërbimit në tokë apo aktivitetet vetëshërbyese të aprovuara. Poseduesi i aprovimit duhet të paraqesë formularin e aprovimit duke deklaruar ndryshimin e dëshiruar të aprovimit. Në rastet kur ndryshimet përfshijnë shërbimet në një aeroport të ri, e tërë procedura për aprovim fillestar duhet të ndiqet për lokacionin e ri. Përndryshe, kur ndryshimi nënkupton vetëm rritjen/uljen e fushëveprimit të shërbimit në tokë apo aktiviteteteve vetëshërbyese të aprovuara, AAC-ja do të kryejë një auditim ose vlerësim pas pranimit të formularit të aprovimit. Përveç kësaj, AAC-ja do të rishikojë të gjitha dokumentet relevante të përcaktuara në Kapitullin 2 për saktësi dhe mjaftueshmëri. AAC-ja do të nxjerr një raport të auditimit duke deklaruar të gjitha mospërputhshmëritë e gjetura, ndërsa krahas kësaj, aplikuesi duhet të zhvillojë planet adekuate korrigjuese të veprimit dhe ta zbatojë atë brenda periudhës së paraparë kohore, në mënyrë që AAC-ja t'i mbyllë gjetjet e saj. Në rast të mosveprimit si më lart, mund të krijohet baza për masa detyruese të AAC-së.

Pas përfundimit me sukses të procedurës së përcaktuar në këtë paragraf, AAC-ja do t'i japë aplikuesit aprovimin e ri me fushëveprimin e ri të aprovuar të shërbimeve në tokë ose aktivitetit si vetëshërbyes ose aeroportit të ri, sipas nevojës.

Kapitulli 4 – Mbikëqyrja e ofruesve të aprovuar të shërbimeve në tokë

AAC-ja do të verifikojë rregullisht përmbushjen e kushteve të aprovimit, duke përfshirë edhe realizimin e aktiviteteve të shërbimeve në tokë nga furnizuesi ose përdoruesi i aeroportit. AAC-ja do të kryejë auditime apo vlerësime në bazë të standardeve IATA - programit ISAGO, dhe në lidhje me sigurinë e shërbimeve të ofruara nga furnizuesi ose përdoruesi i aeroportit. Varësisht nga madhësia e kompanisë dhe fushëveprimi i aktiviteteve të shërbimeve në tokë, kjo mund të kërkojë një auditim të plotë me kohëzgjatje prej një jave ose mund të jetë një verifikim i shkurtër në rast të një fushëveprimi shumë të kufizuar të aktiviteteve me shkallë të vogël. AAC-ja do të nxjerr një raport të auditimit/vlerësimit ku deklaron të gjitha mospërputhshmëritë e gjetura, ndërsa aplikuesi njëkohësisht duhet të:

- a) hartoj një plan adekuat për veprimet korigjuese
- b) verifikoj me AAC-në përshtatshmërinë e veprimeve korigjuese të planifikuara
- c) korigjojë mospërputhshmëritë e deklaruara sipas planit të verifikuar të veprimeve korigjuese
- d) informojë AAC-në në lidhje me veprimet korigjuese të ndërmarra, dhe
- e) pas realizimit të këtyre më lart, AAC-ja do të mbyllë të gjeturat e veta.

Detyrimet e poseduesit të aprovimit

Më së voni deri më 30 qershor të çdo viti, poseduesi i aprovimit duhet të dorëzojë në AAC dëshmi të aftësisë financiare për vitin e kaluar kalendarik përmes dorëzimit të dokumenteve të mëposhtme:

- Raportet vjetore financiare të audituara;
- Informata mbi besueshmërinë dhe aftësinë paguese;
- Informata mbi pajtueshmërinë tatimore;
- Certifikatat dhe licencat e ripërtërira që janë dorëzuar gjatë procesit të aprovimit;
- Raporti i investimeve dhe plani i investimeve për vitin aktual dhe tri vitet e ardhshme;
- Dokumentet tjera me kërkesë të AAC-së.

Poseduesi i aprovimit duhet të dorëzojë në AAC mbulimin e sigurimit përmes dorëzimit të dokumenteve të mëposhtme:

- Ripërtërirja e policës së sigurimit dy javë para skadimit të asaj ekzistueses dhe zotimi për të njoftuar AAC-së në rast të ndryshimeve të policës së sigurimit.